



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**  
**Mbledhja nr. 148/2024**  
**Prishtinë, më 5.11.2024, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

**Munguan:** Armend Muja dhe Abelard Tahiri, anëtarë.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 29.10.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Përzgjedhës për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në ARRU”;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 29.10.2024**

*Procesverbali nga mbledhja e mbajtur me datë 29.10.2024, u miratua pa vërejtje.*

**3. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Përzgjedhës për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në ARRU**

**Kryetari**, tha se sot Paneli intervistues zhvilloj procesin intervistues për këtë pozitë, ku erdhëm në përfundim se është dakordim unanimit i të gjithë anëtareve të panelit intervistues, bazuar në

performancën e kandidatëve gjatë procesit të intervistimit, asnjëri nga kandidatët nuk ka plotësuar kriteret minimale për të proceduar në seancë si kandidatë potencial për “Kryesues të Komisionit Shqyrtues në ARRU. Shto këtu faktin se as në aspektin e konkurrencës nuk kishte kandidatë, ku kanë aplikuar vetëm katër kandidatë, një kandidatë në fund u tërhoq, ku prej tre kandidatëve të intervistuar, sipas ligjit duhet dy të procedohen në seancë dy për tu zgjedhur një. Andaj, si kryesues i Panelit sipas detyrës zyrtare, rekomandoj që konkursi për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në ARRU”, të rishpallet.

*Pas debatit, Komisioni, unanimisht nxori këtë:*

#### V E N D I M

1. *Të rishpallet konkursi për zgjedhjen e “Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit – ARRU”;*
2. *Vendimit i bashkëngjitet teksti i konkursit, në bazë të Ligjit;*
3. *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.*

#### **4. Të ndryshme**

##### **Çështjet vijuese**

**Kryetari**, njoftoi për çështjet në vijim:

- a) Përgjigjet nga ZRRE-ja për ankesën e zyrtares të kësaj agjencie e keni marrë, tha se përgjigja e ZRRE-së ti dërgohet palës më këshillën që ajo të drejtat e saj ti kërkojë në rrugë ligjore, ndërkaq, Komisioni do ta trajtojë më bordin e ZRRE-së, në takimet që do të këtë më rastin e raportimit.
- b) Përgjigjen nga Departamenti ligjor e keni marrë për “konfliktin e ligjit ngritur nga ARRU-ja” ku ata e kanë shpallur veten jokompetent, tha nëse deputetët e vlerësojnë ta ndryshojnë ligjin të marrin nismë ligjore ose të njoftohet ZKM me shkresën e ARRU-së.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:20.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Ferat Shala,**

-----  
**Kryetar i Komisionit**